

Selcom Sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	10,156,070	7,421,936
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	18,809,092	20,551,490
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	3,017,678	1,460,757
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	5,057,196	6,016,975
Inventari	8	3,246,916	2,889,907
Shpenzime të shtyra	9	1,428,529	1,781,338
Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara	10	2,201,631	2,386,839
Totali i aktiveve afatshkurtra		43,917,112	42,509,242
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	11	37,992,897	37,929,485
Aktive afatgjata jomateriale	12	24,184	30,706
Totali i aktiveve afatgjata		38,017,081	37,960,191
Totali i aktiveve		81,934,193	80,469,433
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	64,317	3,402,330
Llogari të pagueshme tregtare	14	5,809,027	2,174,295
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	57,839,846	324,448
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	16	51,740	2,040,126
Detyrime tatimore	17	981,070	954,871
Të ardhurat e shtyra	18	60,200	60,200
Të tjera detyrime	19	4,657,168	6,312,388
Totali i detyrimeve afatshkurtra		69,463,368	15,268,658
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	20	2,852,369	2,604,429
Totali i detyrimeve afatgjata		2,852,369	2,604,429
Totali i detyrimeve		72,315,737	17,873,087
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	21	100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		-	54,886,108
Fitimi i ushtrimit		9,508,456	7,600,238
Totali i kapitalit		9,618,456	62,596,346
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		81,934,193	80,469,433

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Selcom Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	57,429,031	78,570,957
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar		3,007,951	5,172,698
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	23	(240,894)	(413,032)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(34,148,717)	(58,947,614)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	24	(27,918,655)	(52,905,837)
2) Të tjera shpenzime	25	(6,230,062)	(6,041,777)
Shpenzime të personelit	26	(11,380,498)	(11,790,828)
1) Paga dhe shpërblime		(9,983,507)	(10,286,829)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(1,396,991)	(1,503,999)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11/12	(3,385,435)	(3,351,071)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	27	(786)	(2,626)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	28	(79,865)	(262,239)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(75,310)	(253,025)
2) Shpenzime të tjera financiare		(4,555)	(9,214)
Fitimi/humbja para tatimit		11,200,787	8,976,245
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	29	(1,692,331)	(1,376,007)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,692,331)	(1,376,007)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		9,508,456	7,600,238
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		9,508,456	7,600,238

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Selcom Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	10,000	38,610,884	16,275,224	54,996,108
Fitimi / Humbja e vitit				7,600,238	7,600,238
Lëvizjet përmes kapitalit			16,275,224	(16,275,224)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	10,000	54,886,108	7,600,238	62,596,346
Fitimi / Humbja e vitit				9,508,456	9,508,456
Dividendë të paguar			(54,886,108)	(7,600,238)	(62,486,346)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000	10,000	-	9,508,456	9,618,456

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

 
Altin Bushka
Administrator
Residenca "Kodra e Diellit", Tiranë
NUIB: K 61920009
Tel: (02) 4100000, (02) 6300000

 MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

Mazars Shpk

Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave Financiare

Selcom Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		9,508,456	7,600,238
Diferenca këmbimi jo nga aktivitetet operative		212,329	(84,616)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		3,385,435	3,351,071
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		1,683,273	6,964,263
Rënie/(rritje) në inventarë		(357,009)	1,805,824
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		1,998,765	(1,228,023)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		(1,953,480)	(1,184)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		14,477,769	18,407,573
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(3,442,325)	(6,379,450)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(3,442,325)	(6,379,450)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Pagesa e huave		(3,101,610)	(8,648,768)
Dividendë të paguar		(4,998,908)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(8,100,518)	(8,648,768)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		2,934,926	3,379,355
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		7,421,936	3,948,751
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		(200,792)	93,830
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	10,156,070	7,421,936

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Selcom" sh.p.k (Kompania) me nipt K61920009K është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Korrik 2006 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lekë, i ndarë në 100 njësi të barabarta me nga 1,000 Lekë secila.

Ortakët e shoqërisë janë:

- Z. Gentian Sula zotërues i 65 kuotave ose 65% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Altin Bushka zotërues i 35 kuotave ose 35% të kapitalit të shoqërisë;

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ofrimi i shërbimeve të telefonisë, internetit. Projektim dhe zbatim i rrjeteve dhe sistemeve telefonike, rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike, sistemeve të vëzhgimit me kamera IP dhe me qark të mbyllur. Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve elektronike.

Adresa e selisë së shoqërisë është: Selitë, Tiranë, Rruga e Jaseminëve, Rezidenca Kodra e Diellit, Njesia e shërbimit nr 43, A O/1 Nr pasurie 118/8/9.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte 15 punonjës (2018: 15 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga NAS për prezantimin e pasqyrave financiare.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)**

Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/ALL	121.77	123.42
USD/ ALL	108.64	107.82

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë kostot e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orëndi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Ndërtime dhe instalime	Vlerë e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivët dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	9,951,642	3,271,652
Llogari rrjedhëse	9,951,642	3,271,652
Depozita fonde të ngurtësuara	-	-
Mjete monetare në arkë	204,428	4,150,284
	10,156,070	7,421,936

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë	18,809,092	20,551,490
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	-	-
	18,809,092	20,551,490

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	3,017,678	1,460,757
	3,017,678	1,460,757

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tatim mbi fitimin	643,393	1,603,172
Debitorë, kreditorë të tjerë	4,413,803	4,413,803
	5,057,196	6,016,975

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lëndë e parë dhe materiale	906,514	504,311
Mallra për rishitje	392,857	392,857
Inventari l imet	1,947,545	1,992,739
	<u>3,246,916</u>	<u>2,889,907</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	260,774	257,120
Parapagime për furnitorët	1,167,755	1,524,218
	<u>1,428,529</u>	<u>1,781,338</u>

10. Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara

Të arkëtueshmet nga të ardhurat e konstatuara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura të llogaritura nga telefonia	2,201,631	2,386,839
	<u>2,201,631</u>	<u>2,386,839</u>

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive afatgjata materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Instrumenta dhe vegla pune	Ndertime dhe instalime	Te tjera	Totali
Kosto								
Gjendja më 31 dhjetor 2017	24,824,703	1,542,988	266,698	2,568,824	140,378	29,566,197	977,067	59,886,855
Shtesa	434,945			754,307		5,148,661	41,537	6,379,450
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25,259,648	1,542,988	266,698	3,323,131	140,378	34,714,858	1,018,604	66,266,305
Shtesa	363,356				50,000	3,007,951	21,018	3,442,325
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25,623,004	1,542,988	266,698	3,323,131	190,378	37,722,809	1,039,622	69,708,630
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 31 dhjetor 2017	16,814,861	642,511	215,318	1,438,063	70,218	5,371,722	439,578	24,992,271
Amortizimi i vitit	1,514,917	180,095	8,162	245,985	12,644	1,270,402	112,344	3,344,549
Gjendja më 31 dhjetor 2018	18,329,778	822,606	223,480	1,684,048	82,862	6,642,124	551,922	28,336,820
Amortizimi i vitit	1,318,195	144,076	6,530	332,820	18,448	1,464,315	94,529	3,378,913
Gjendja më 31 dhjetor 2019	19,647,973	966,682	230,010	2,016,868	101,310	8,106,439	646,451	31,715,733
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 dhjetor 2017	8,009,842	900,477	51,380	1,130,761	70,160	24,194,475	537,489	34,894,584
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,929,870	720,382	43,218	1,639,083	57,516	28,072,734	466,682	37,929,485
Gjendja më 31 dhjetor 2019	5,975,031	576,306	36,688	1,306,263	89,068	29,616,370	393,171	37,992,897

12. Aktive afatgjata jo materiale

	AAJM	Totali
Kosto		
Gjendja më 31 dhjetor 2017	87,476	87,476
Shtesa		-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	87,476	87,476
Shtesa		-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	87,476	87,476
Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendja më 31 dhjetor 2017	50,248	50,248
Amortizimi i vitit	6,522	6,522
Gjendja më 31 dhjetor 2018	56,770	56,770
Amortizimi i vitit	6,522	6,522
Gjendja më 31 dhjetor 2019	63,292	63,292
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 dhjetor 2017	37,228	37,228
Gjendja më 31 dhjetor 2018	30,706	30,706
Gjendja më 31 dhjetor 2019	24,184	24,184

13. Hua aftashkurta

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Overdraft	64,317	3,402,330
	64,317	3,402,330

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë vendas	2,116,401	2,174,295
Furnitorë të huaj	3,692,626	-
	5,809,027	2,174,295

15. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për dividendin ndaj ortakëve	57,487,438	-
Të pagueshme tregtare nga palët e lidhura	352,408	324,448
	<u>57,839,846</u>	<u>324,448</u>

16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të konstatuara për telefoninë	-	1,938,526
Shpenzime të konstatuara të tjera	51,740	101,600
	<u>51,740</u>	<u>2,040,126</u>

17. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH për t'u paguar	710,907	699,646
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	198,014	184,298
Tatimi mbi te ardhurat nga punësimi	71,063	69,927
Detyrime doganore	1,086	1,000
	<u>981,070</u>	<u>954,871</u>

18. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagim nga klientë	60,200	60,200
	<u>60,200</u>	<u>60,200</u>

19. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paga për t'u paguar	528,384	2,481,864
Debitorë dhe kreditorë të tjerë për modema	1,942,364	1,616,698
Të tjera detyrime	2,186,420	2,213,826
	4,657,168	6,312,388

20. Llogari të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme të tjera ndaj ortakeve	2,852,369	2,604,429
	2,852,369	2,604,429

21. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 100,000 Lekë. Gjate vitit 2019 nuk ka pasur ndryshim në strukturën e kapitalit të shoqërisë.

22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga telefonia	38,937,704	59,589,424
Të ardhura nga interneti	18,405,244	18,970,533
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	86,083	11,000
	57,429,031	78,570,957

22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

	31 dhjetor 2019
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	78,637,402
Autofatura	(17,689,546)
Garanci për modema	(325,666)
Anullim i të ardhurave të 2018 deklaruar në 2019	(2,386,839)
Perlllogaritje e të ardhurave të 2019 deklaruar në 2020	2,201,631
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	60,436,982
 Të ardhurat telefoni/internet	 57,342,948
Shitje mallra/materiale	86,083
Shitje AQT	
Të ardhura nga prodhimi i AQT	3,007,951
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	60,436,982
 Të ardhurat nga interesat	 33
Të ardhura të tjera financiare	7,084
Fitim nga kembimet valutore	87,948
Total të ardhura të deklaruar FDP-në e Tatim Fitimit	60,532,047

23. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitime nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	82,971	340,309
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(323,865)	(753,341)
	(240,894)	(413,032)

24. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Nënkontraktorë	24,693,739	47,289,134
Kosto e materialeve	1,467,608	3,899,695
Materiale të tjera ndihmëse	1,208,808	1,717,008
Karburant	498,500	-
Kosto e mallrave të shitur	50,000	-
	27,918,655	52,905,837

25. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Konsulencë ekonomike	1,680,000	1,440,000
Shpenzime qiraje	1,614,519	1,656,661
Taksa dhe tarifa të ndryshme	897,889	1,031,167
Shpenzime utilitare	459,724	369,548
Mirëmbajtje dhe riparime	445,442	323,223
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	290,630	184,145
Shpenzime administrative	276,167	328,227
Blerje të ndryshme, kancelari etj	217,720	152,220
Komisione bankare	177,974	273,777
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	80,636	167,507
Siguracione	78,711	78,302
Publicitet, reklama	9,000	10,000
Shpenzime për pritje dhe dhurata	1,650	27,000
	6,230,062	6,041,777

26. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	9,983,507	10,286,829
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,396,991	1,503,999
	11,380,498	11,790,828

27. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjoka dhe penalitete	786	2,626
	<u>786</u>	<u>2,626</u>

28. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura të tjera financiare	7,084	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	5,003	51,992
Të ardhura nga interesat	33	246
Shpenzime të tjera financiare	(102)	-
Humbje nga këmbimet valutore	(16,540)	(61,206)
Shpenzime për interesa	(75,343)	(253,271)
	<u>(79,865)</u>	<u>(262,239)</u>

29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Fitimi para tatimit	11,200,787	8,976,245
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	<u>81,422</u>	<u>197,133</u>
Shpenzime pritje & percjellje, dhurata	-	27,000
Penalitet, gjoka e dëmshpërblime	786	2,626
Shpenzime të tjera	80,636	167,507
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	<u>11,282,209</u>	<u>9,173,378</u>
 Tatim fitimi 15%	 1,692,331	 1,376,007
	<u>9,508,456</u>	<u>7,600,238</u>

30. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
S&D Invest	352,408	324,448
Gentian Sula	37,914,032	530,932
Altin Bushka	22,425,775	2,073,497
	<u>60,692,215</u>	<u>2,928,877</u>
 Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
BPO Solution	-	-
S&D Invest Sha	1,591,159	1,460,757
Art and Tourism Development Group	1,426,519	-
	<u>3,017,678</u>	<u>1,460,757</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
S&D Invest Sha	109,531	85,613
Art and Tourism Development Group	1,233,033	-
	<u>1,342,564</u>	<u>85,613</u>
 Blerje nga palët e lidhura		
S&D Invest Sha	259,600	253,717
Art and Tourism Development Group	1,375	-
	<u>260,975</u>	<u>253,717</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

31. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2019, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

32. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.